



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org Unit	Nr. Prof. Br. Prof.
Nr. i faqëve Broj stranica No. pages	Datum. Date:
01/3	945 18.05.26
PRISHTINË:A N.O.1	

Raporti mbi të arriturat e Ndërmarrjes TM1-2026 të NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, krahasuar me TM1-2025

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen katër (4) të rregullt të mbajtur me datë 12.05.2026 pas shqyrtimit të raportit për të arriturat e Ndërmarrjes TM1-2026 të NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, krahasuar me TM1-2025 mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv:	Kryesuesi i BD:
Nënshkrimi	Faruk MUJKA	Bajram MUSTAFA
Data: 12.05.2026		







Republika e Kosovës Republika Kosova
- Republic of Kosova
Qeveria - Vada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije – Ministry of Economy



Ndërmarrja Hidroekonomike
Hydro-economic Enterprise
Vodoprivredno Preuzeće
"IBËR-LEPENC" Sh. A.
Bulevardi "Bill Clinton" 13 - PRISHTINË

RAPORT MBI TË ARRITURAT NË TREMUJOR

1. RAPORTIMI FINANCIAR DHE OPERATIV

Rritja/ Ulja e të hyrave:

Të hyrat	2025	2026	Diferenca	Raporti TM %
TM 1	2,556,666.95	3,493,872.85	937,205.90	37%
TM2				
TM3				
TM4				
Total	2,556,666.95	3,493,872.85	937,205.90	37%

Rritja/ Ulja e shpenzimeve të pagave:

Shpenzimet e pagave	2025	2026	Raporti TM %
TM 1	905,946.25	995,303.19	9.86%
TM 2			
TM 3			
TM 4			
Total	905,946.25	995,303.19	9.86%

Rritja/Ulja e shpenzimeve operative:

Shpenzimet operative	2025	2025	Raporti TM %
TM 1	1,198,465.99	1,410,629.28	17.70%
TM 2			
TM 3			
TM 4			
Total	1,198,465.99	1,410,629.28	17.70%

Rritja/Reduktimi i prodhimit (indiktorët operativ varësisht nga veprimtaria e NP-së):

Rritja/ Ulja e Prodhimit nga Energjia elektrike(Mwh)

	2025	2026	Raporti TM %
TM 1	11,646.75	26,584.14	+ 128.25
TM 2	26,161.32		
TM 3	10687.63		
TM 4	21,614.78		

Rritja/ Ulja nga distribuimi i ujit (m³)

	2025	2026	Raporti TM %
TM 1	14,642,480.00	13,761,748	- 6.2
TM 2	15,343,240.00		
TM 3	20,759,075		
TM 4	13,874,789		

Fitimi/Humbja financiare (neto) e NP (emri i NP) Sh. A. përgjatë TM:

TM	2025			2026			Raporti i Fitimi/Humbja neto %
	Të hyrat (totale)	Shpenzimet (totale)	Fitimi/Humbja neto	Të hyrat (totale)	Shpenzimet (totale)	Fitimi/Humbja neto	
TM1	2,556,666.95	2,349,669.32	206,997.63	3,493,872.85	2,603,755.03	890,117.82	330.01%
TM2							
TM3							
TM4							
Totali	2,556,666.95	2,349,669.32	206,997.63	3,493,872.85	2,603,755.03	890,117.82	330.01%

2.VEPRIMET E NP NGA ASPEKTI LIGJOR

Padi me propozim për masë të sigurisë gjatë TM1 nuk ka pasur në NH "Ibër Lepenc" Sh.A.

Padi nga ana NP "Ibër Lepenc" Sh. A. për lirimin e pronës dhe fitimit të humbur si dhe lëndë të tjera, gjatë TM1 2026 është zhvilluar procedurë për lëndët e mëposhtme:

Nr.	I paditur/debitor	Paditës/kreditor	Kontesti	Rrjedha
1.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Jahir Zeneli	Vertetim pronësie	Me datën 09.01.2026, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri, është mbajtur seanca fillestare, në të cilën kemi marrë pjesë ne si palë e paditur dhe pala paditëse. Në këtë seancë kemi shprehur qëndrimet tona duke kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë. Me kërkesë të palës paditëse, është shtyrë seanca për datën 16.01.2026, në të cilën ka paraqitur tërheqjen e padisë.

2.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Akip Imishti	Vertetim Pronësie	Me datën 30.12.2025 kemi pranuar aktvendimin me numër C.nr.2130/18, me të cilin padia e paditësit është hedhur poshtë si e palejueshme. Kundër këtij aktvendimi, me datë 13.01.2026 kemi paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa me datë 23.01.2026, kundër të njejtit aktvendim kemi pranuar ankesë nga perfaqësuesi i palës paditëse av.Dren Salihu
3.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Xhemshit Shala	Kompenzim dëmi	Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datën 22.01.2026, kemi dorëzuar kundërshtimin ndaj ekspertizave të gjeodezisë dhe të bujqësisë, ndërsa me datën 26.01.2026 është mbajtur seanca, në të cilën kanë munguar ekspertët. Seanca perfundimtare është mbajtur me date 02.03.2026 në të cilën kemi shprehur kundërshtimet tona, jemi në pritje të aktgjykimit.
4.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Agim Pllashniku	Kontest Pune	Me datën 26.01.2026 kemi pranuar padinë e ushtruar nga Agim Pllashniku kundër N.H. Ibër-Lepenc Sh.A, ndërsa me datën 09.02.2026 në Gjykatën Themelore në Prishtinë kemi dorëzuar përgjigje në padi me numër 02-363. Me datën 30.03.2026, në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca përgatitore, në të cilën palët kanë shprehur qëndrimet e tyre. Paditësi ka kërkuar caktimin e ekspertit financiar, ndërsa gjykata ka vendosur që për këtë çështje të vendosë me aktvendim jashtë seance. Për seancën e radhës, palët do të njoftohen me ftesë të rregullt.

5.	Ismet Mehmeti	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Lirim Prone	Më datë 23.01.2026, nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar ankesën kundër aktgjykimit me numër C.nr. 1748/13, të datës 05.11.2024, ndërsa më datë 26.01.2026, në të njëjtën gjykatë, kemi dorëzuar përgjigjen në ankesë.
6.	Hajrush Azemi	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Lirim Prone	Me datën 02.02.2026 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është mbajtur seanca fillestare, ku palët kanë paraqitur qëndrimet e tyre. Gjykata ka vendosur që të bëhet nxjerrja e ekspertizës, presim ftesen për seancën e radhës.
7.	Bahri Seferi	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Lirim Prone	Me datën 04.02.2026, në Gjykata Themelore në Mitrovicë, është mbajtur seanca gjyqësore në të cilën ka munguar pala. Për shkak të mungesës së palës, seanca është shtyrë dhe seanca e radhës është caktuar të mbahet më datën 24.03.2026. Me datën 24.03.2026, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është mbajtur seanca gjyqësore, në të cilën ka munguar pala. Për shkak të mungesës së saj, seanca është shtyrë, persesri, ndërsa seanca e radhës është caktuar të mbahet më datën 05.05.2026.
8.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Naser Mulaku	Kompenzim Dëmi	Me datë 04.03.2026, në Gjykatën Themelore në Drenas është mbajtur seanca gjyqësore, gjatë së cilës palët kanë paraqitur qëndrimet e tyre dhe kanë paraqitur kërkesat përkatëse.
9.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Bujar Shala	Kontest Pune	Me datën 05.02.2026, nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar aktvendimin me numër 08/4-345 dhe padinë e ushtruar nga Bujar Shala,

				ndërsa me datën 20.02.2026 kemi dorëzuar përgjigje në padi me numër 02-489, seanca do të mbahet me datën 14.04.20256
10.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Besnik Krasniqi	Kontest Pune	Me datën 20.02.2026, nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar aktvendimin me numër 08/4-492 dhe padinë e ushtruar nga Besnik Krasniqi, ndërsa me datën 05.03.2026 kemi dorëzuar përgjigje në padi dhe jemi në pritje të ftesës për seancë.
11.	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Besim Beka	Kompenzim dëmi	Me datën 03.03.2026 kemi pranuar ekspertizën e bujqësisë, të cilën e kemi kundërshtuar përmes një shkrese në seancën e datës 23.03.2026, e cila është mbajtur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në të cilën palët kanë shprehur qëndrimet e tyre. Seanca e radhës është caktuar të mbahet me datën 27.07.2026.
12.	Naim Leci	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Lirim prone	Me datën 25.03.2026, nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar aktgjykimin e datës 21.11.2025, me numër protokolli 02-833, të datës 25.03.2026, me numër të lëndës C.nr.1689/13, me të cilin miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.H. "Ibër Lepenc".
13.	NH "Ibër Lepenc" Sh.A	Future Energy Trading and Exchange Dynamics Sh.P.K,	Shpërblim dëmi për shkak të mos përmbushjes së kontratës	Me datën 30.03.2026 nga Gjykata Komerciale ne Prishtinë kemi pranuar ftesën për seancë e cila është caktuar të mbahet më datën 14.05.2026, të cilën e kemi përcjellë në shoqërinë aksionare te avokatëve për shqyrtim, sipas kontratës dhe obligimeve kontraktuale.